

Buletini i Lajmeve të Sigurisë Kibernetike

Nëntor 2022

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKCESK Z. IGLI TAFI ZHVILLON TAKIM ME AMBASADORIN AT LARGE PËR HAPËSIRËN KIBERNETIKE DHE POLITIKAT DIGJITALE TË SHBA, Z. NATHANIEL FICK



Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK, në rolin edhe të Koordinatorit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, z. Igli Tafa zhvilloi një takim me Ambasadorin at Large për Hapësirën Kibernetike dhe Politikën Digjitale të SHBA, Z. Nathaniel Fick.

Takimi u zhvillua në kuadër të angazhimeve të qeverisë Shqiptare, për forcimin e aleancave me partneret strategjike, në funksion të rritjes së nivelit të Sigurisë Kibernetike në vend. Ambasadori Fick, shprehu gatishmërinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të mbështetur Shqipërinë si vend aleat i saj, në rritje të kapaciteteve në funksion të mbrojtjes kibernetike, si dhe në forcimin e bashkëpunimit në këtë fushë. Gjithashtu, z. Tafa e siguroi Ambasadorin Fick, për përmbushjen e angazhimeve si vend i Aleancës Euro-Atlantike, duke marrë masat e nevojshme për krijimin e një ekosistemi kibernetik të sigurt në Shqipëri. Pas takimit, Ambasadori Fick, vizitoi edhe ambientet e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

SIGURIA KIBERNETIKE NË SEKTORIN BANKAR, NË FOKUS TË AKCESK, MBI PARIMIN E NDËRTIMIT TË BESIMIT!



Në kuadër të zhvillimeve aktuale në fushën e sigurisë kibernetike, Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK z. Igli Tafa, më datë 23 nëntor, zhvilloi takimin me temë "Siguria kibernetike në sektorin bankar".

Në këtë takim morën pjesë drejtuesit më të lartë të sigurisë në këtë sektor. Z. Tafa, shpalosi vizionin e ri të AKCESK nën drejtimin e tij, duke e vendosur sektorin bankar si një ndër prioritetet me impaktin më të madh në sigurinë e informacionit. Ky është shërbim, në kuadër të angazhimeve primare të Qeverisë shqiptare për garantimin e të dhënave financiare të qytetarëve dhe të sektorit bankar në tërësi. Masat e sigurisë të nivelit të lartë dhe ngritja e qendrës operacionale të sigurisë kibernetike, angazhime afatshkurtra të AKCESK, ishin kryefjala e diskutimeve në këtë takim, si një hap i rëndësishëm për rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike. Përfaqësues të sektorit bankar shprehën gatishmërinë për të mbështetur AKCESK, nëpërmjet Shoqatës së Bankave pranë së cilës është ngritur grupi i ekspertëve më të mirë të sigurisë kibernetike, të cilët do të ndërveprojnë me Autoritetin në raste të incidenteve kibernetik

RRITJA E NDËRVEPRIMIT INSTITUCIONAL, PRIORITET NË RITJEN E NIVELIT TË SIGURISË KIBERNETIKE NË VEND!

Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK, në rolin edhe të Koordinatorit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, i konsideroi çështjet e ndërveprimit institucional dhe çështje të tjera lidhur me sigurinë kibernetike, prioritet për krijimin e një mjedisi të sigurt kibernetik kombëtar, sot gjatë takimit me përfaqësues të lartë nga institucionet e mbrojtjes dhe sigurisë.

AKCESK, në rolin e autoritetit përgjegjës, është gjithmonë në dispozicion, për të lehtësuar çdo proces lidhur me identifikimin e infrastrukturave kritike të informacionit, rritjen e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për sigurinë, dhe implementimin e masave të sigurisë kibernetike për këto infrastruktura.

Objektivi për krijimin e një ekosistemi kibernetik të sigurt në vend, fillon pikërisht nga ndërveprimi institucional!

